



VENDIM
Nr. 71 Datë 11.10.2010

PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË
KESH SH.A PËR MIRATIMIN E PLANT TË INVESTIMEVE TË VITIT
2011

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Aplikimi i KESH sh.a për planin e investimeve për vitin 2011 përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Të fillojë proçedurat për shqyrtimin e aplikimit të KESH sh.a për miratimin e plant të investimeve të vitit 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH Sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtar.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA

